



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

17/131/4

UDHËZIM

11. 8. 2014

NR. 1/1 , datë 11/08/2014

Për disa shtesa në Udhëzimin Nr.01, datë 14. 01. 2011 “Mbi procedurën e përpunimit të deklarimit doganor (DAV) në Sistemin Asycuda World”

Në zbatim të Ligjit Nr. 8449, datë 27.01.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë” Neni 86(b) si dhe nenit 147 të Dispozitave Zbatuese të Vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, mbi procedurën e përpunimit të deklarimit doganor (DAV) në Sistemin Asycuda World”

UDHËZOJ:

Ndryshimet në Udhëzimin Nr.01, datë 14. 01. 2011 “Mbi procedurën e përpunimit të deklarimit doganor (DAV) në Sistemin Asycuda World” në pikat:

Në pikën 21 shtohet pika:

e. Në rastet kur në inkotermin e deklaruar janë të përfshira dhe shpenzimet e transportit deklaruesi e ka të detyrueshme të plotësojë në kuadratin “Vlera të transportit të jashtëm” shpenzimet e transportit, e cila duhet të shoqërohet dhe me faturë ose nqs transporti kryhet nga vetë shoqëria (leja e qarkullimit të mjetit të transportit duhet të jetë në emërin e shoqërisë) një deklaratë që pasqyron këto shpenzime.

Pika 23 ndryshon;

Doganieri i kontrollit dokumentar do të ndërhyjë vetëm në fushën “Kosto të tjera” kur gjatë aktit të vlerësimit të shpenzimeve të transportit konstaton parregullsi si dhe në kutinë 45 të DAV-it për metodën e vlerësimit doganor të aplikuar për mallrat.

Në vijim doganieri i kontrollit duhet të plotësojë edhe aktin e kontrollit ku ai duhet të tregojë llojin e parregullsive të konstatuara si dhe shumën e penaliteve nëse duhen vënë sipas rastit së bashku me numrin e vendimit të marrë nga autoritetet doganore.

Pikat 33 deri 40 shfuqizohen;

Bazuar në Udhëzimit nr.5 -datë 06.07.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Mbi procedurën e pagesave (e-payment) të operatorëve ekonomikë, në kuadër të implementimit të pagesave On-line, në një llogari bankare të centralizuar arkëtimesh, të çelur në bankat e nivelit të dytë, për të ardhurat doganore, të akcizës dhe detyrimeve të tjera të pagueshme në doganë” nga ana e Sektorit të Kontabilizimeve të Ardhurave dhe Pagesave të Bankës” ka ndryshuar procedura në lidhje me pagesat e detyrimeve doganore.

Për paraqitjen e vlerës së shpenzimeve të transportit në aktin e vlerësimit të DAV-it sipas rasteve të paraqitura do të vepronet si vijon:

Në rastet kur në faturën e mallrave nuk përfshihen shpenzimet e transportit;

- Në kutinë 22 të DAV vendoset - vlera e faturuar e mallit.
- Kutia 44 e DAV, “Vlera e transportit të jashtëm – vendosen shpenzimet e transportit të shoqëruara me faturë (vetëm për shpenzimet e transportit). Ky plotësim bëhet nga deklaruesi.
- Kutia 44 e DAV, “Kosto të tjera”- rregullimet në shpenzimet e transportit. Rregullimi bëhet nga doganieri i kontrollit dokumentar.

Artikulli numri	Shuma	FCX kod	Kernbiri Perqindja	Shuma ne Lek njesi monetare
Vlera e fatures.....	1,000.00	ne EUR	139.880	139,880
Vlera e Transportit te Jashtem	200.00	ne EUR	139.880	27,972
Transport i brendshem.....	0.00	ne	0.000	0
Sigurecioni.....(import)	0.00	ne	0.000	0
Kosto te tjera (impo...)	300	ne EUR	139.880	41,958
Zbriljet	0.00	ne	0.000	0
Kosto totale				88,830
Kushtet e levrimit EXW berlin				Vlera e CIF 209,790
				Vlera statistikore 209,790

Në rastet kur në faturën e mallrave përfshihen shpenzimet e transportit;

- Në kutinë 22 të DAV vendoset - vlera e faturuar e mallit.
- Kutia 44 e DAV, “Vlera e transportit të jashtëm – vendosen shpenzimet e transportit të shoqëruara me faturë (vetëm për shpenzimet e transportit). Ky plotësim bëhet nga deklaruesi dhe është për të identifikuar këto shpenzime në vlerën totale.
- Kutia 44 e DAV, “Kosto të tjera”- rregullimet në shpenzimet e transportit. Rregullimi bëhet nga doganieri i kontrollit dokumentar.

- Kutia 44 e DAV, "Zbritjet"- vendoset vlera e shpenzimeve të transportit të faturuar (e plotësuar në "Vlera e transportit të jashtëm). Ky plotësim bëhet për të shmangur dublimin e vlerës së shpenzimeve të transportit pasi ato janë të përfshira në vlerën e faturuar të mallit.

ASVCLDAWorld lindita.zita

Skedar Paraqitje Dritare Ndihme

Deklarimi i detajuar - E re [2014]

Skedar Editë Paraqitje Ndihme

100 %

LAJMERIM MIRATIMI - artikulli

Artikulli numri

	Shuma	FCX kodi	Kembimi Pergjndje	Shuma ne Lek njesi monetare
Vlera e fatures.....	1,000.00	ne EUR	140.260	140,260
Vlera e Transportit te Jashtem	200.00	ne EUR	140.260	28,052
Transport i brendshem.....	0.00	ne	0.000	0
Sigurimi..... (import)	0.00	ne	0.000	0
Kosto te tjere..... (impo...	300.00	ne EUR	140.260	42,078
Zbritjet	200.00	ne EUR	140.260	28,052
			Kosto totale	42,078
Kushtet e levimit CIF			Vlera e CIF	182,338
			Vlera statistikore	182,338

Informacion shtese

D.A.V. | Le Mir | Artikulli Akti i Vleresimit | Niveli i Prerimit | Fajla Info... | Dok. Buzë...

Libraria e Doku... | Deklarimi i detaj...

start | 2 Adobe Reader 8.0 | 2 Windows Explorer | ndryshim udhezimi i A... | ASVCLDAWorld ALBA... | ASVCLDAWorld - lindi... | 10:46 AM

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Elisa SPIROPALI

DREJTORI PËRGJITHSHEM

